



Duke u mbështetur në nenin 43 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, Nr.03/L-040, nenit 47 të Statutit të Komunës dhe nenit 4 të Rregullores për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës bën këtë:

N J O F T I M

Njoftohen të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe të interesuarit tjerë, që të marrin pjesë në seancën e III-të të rregullt të punës për vitin 2018.

Seanca mbahet më 30.3.2018 (e premte), në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe fillon në orën 10:00.

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në seancë, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL-së.

Për këtë seancë propozohet ky:

R E N D I I D I T Ë S

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Pyetje dhe përgjigje,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës së Ekzekutivit për vitin 2017 (referon Ekzekutivi),
5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për bartjen e mjeteve të mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2017 në vitin 2018 (ref. Drejtorja për FEZH),
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për bartjen e mjeteve bashkëfinancim me Donator (ref.drejtorja e FEZH),
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-Vendimit për subvencionimin e klubeve sportive të Komunës së Klinës (referon Drejtorja e KRS),
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për formimin e Këshillit Organizativ të Festivalit Folklorik "I Këndojmë Lirisë" (referon Drejtorja e KRS),
9. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për themelimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës në afat të shkurtër dhe afat gjatë,
10. Formimi i Komisionit të Ankesave lidhur më shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim,
11. Shqyrtimi i petitionit të Partisë Liberale Egjiptase- Dega në Klinë.

01Nr. 06-2023/2018
Klinë, më 27.03/2018

KRYESUESI
Fadil Gashi

